



Tel. 04 268142; Fax 04268141

Tiranë më 10 .02 .2015

VENDIM

Nr 9 Datë 10 / 02 / 2015

“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Qendra Kombëtare e Licensimit”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbikëqyr kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për këtë arsye,

në zbatim të planit të mbikëqyrjes, si dhe me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, me qëllim që të mbikëqyrë zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë,

VENDOSI:

1. Fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin Qendra Kombëtare e Licensimit, sipas objektit dhe anekseve që përmban Programi i Mbikëqyrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngritjen e grupit të inspektimit, me këtë përbërje:
 - **Valentina Kolleshi** Inspektor i mbikëqyrjes
Përgjegjës grupi
 - **Zamira Mujali** Inspektor i mbikëqyrjes
Anëtar
3. Pas raportimit tek Drejtori i Mbikëqyrjes për përfundimin e kqyrjes së akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i mbikëqyrjes, në

drejtimin teknik të Drejtorit, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e Projekt Raportit të Mbikëqyrjes, i cili pas **5 ditësh** do t'i paraqitet Komisionerit për miratim dhe më tej, do t'i dërgohet institucionit të mbikëqyrur për t'u njohur me gjetjet, duke i lënë **5 ditë** kohë për të përgatitur observacionet.

4. Pas përfundimit të afatit për njohjen e subjektit të mbikëqyrur me raportin paraprak, grupi i punës do të hartojë Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes, ku do të përfshihet edhe analiza e observacioneve, e pas **2 ditëve**, do t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
5. Nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes nuk arrihet të respektohen afatet e vendosura, për shkaqe të ndryshme, grupi i punës duhet të kërkojë zgjatje afati tek Komisioneri, duke argumentuar edhe arsyet për mos përfundimin e procesit në afat.
6. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 162/2 Prot.

Tiranë, 10 .02 .2015

MIRATOHET

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM MBIKËQYRJE

(Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil)

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** Qendra Kombëtare e Liçensimit
- 2. Objekti i mbikëqyrjes:** Mbikëqyrje tematike për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me respektimin e kërkesave të përgjithëshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës dhe deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.
- 3. Baza ligjore:**
- Nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që përcaktojnë kompetencat e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- Neni 19 ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që përcakton klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil;
- Neni 21 i ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që përcakton kërkesat e përgjithëshme për pranimin në shërbimin civil;
- Neni 67 i ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që përcakton kategoritë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, kushtet ligjore si dhe procedurat specifike që duhet të ndiqen për realizimin e procesit;

Vendimi nr. 116/2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të Këshillit të Ministrave", i ndryshuar;

Vendimi nr. 142/2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" të Këshillit të Ministrave".

4. Periudha e mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të përfshijë sipas objektit, veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj si pjesmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.

Për verifikimin e zbatimit të ligjit 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", i ndryshuar, në lidhje me mënyrën e rekrutimit, mbikëqyrja do të shtrihet edhe në akte të dala para datës 26 Shkurt 2014.

5. Afati i mbikëqyrjes:

Mbikëqyrja do të fillojë në institucion në datën 18.02.2015 dhe do të përfundojë brenda datës 05.03.2015, sipas fazave të përcaktuara në vendimin për fillimin e mbikëqyrjes.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet proces-verbal administrativ dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

- | | |
|------------------------------|---|
| 1. Valentina Kolleshi | Inspektor
(Përgjegjës grupi), |
| 2. Zamira Mujali | Inspektor
(Anëtar) |

8. Dokumentimi i rezultateve të mbikëqyrjes:

Në përfundim të procesit të qyrjes dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm do të përgatitet projekt - raporti i mbikëqyrjes, me të cilin do të njihen personat përgjegjës për t'i dhënë mundësinë e sqarimeve dhe të paraqitjes së observacioneve. Më pas do të hartohet raporti përfundimtar i mbikëqyrjes i cili do t'i dërgohet institucionit, i shoqëruar me rekomandimet dhe paralajmërimet përkatëse për të rregulluar ligjshmërinë.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit Civil*", apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil.
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
- Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar,
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithëshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit etj).
5. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*".

DREJTORIA E MBIKËQYRJES

Arbana BASHA

DREJTOR